



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE NË FUSHËN E DREJTËSISË DHE**  
**ANTI-KORRUPSIONIT**  
**DREJTORIA E PROGRAMEVE DHE E PROJEKTEVE NË FUSHËN**  
**ANTI-KORRUPSIONIT**  
**SEKTORI I PROGRAMEVE NË FUSHËN ANTI-KORRUPSIONIT**

**Raport konsultimi i draft raportit të monitorimit janar-mars 2021, të Planit të Veprimit të**  
**Strategjisë Ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2015-2023**

- 1. Titulli i draft aktit:** Raporti i monitorimit për periudhën janar-mars 2021, Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023.
- 2. Kohëzgjatja e konsultimeve**
  - Konsultimi i parë (drafti 1) me institucionet zbatuese e raportuese të Planit të Veprimit dhe Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM, ka zgjatur 8 ditë pune (nga data 30 Prill – 12 Maj 2021).
  - Konsultimi në web të Ministrisë së Drejtësisë, ka qenë i hapur. Publikimi është bërë në datë 30.4.2021, në menu: prioritete/strategjia ndërsektoriale/strategjia kundër korrupsionit/raporte monitorimi në [www.drejtësia.gov.al](http://www.drejtësia.gov.al).
  - Konsultimi i dytë (drafti 2) me institucionet zbatuese e raportuese të Planit të Veprimit dhe Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM, është dërguar (i plotë) për rishikim dhe vlerësim kontributi në datë 7.6.2021 dhe është finalizuar me zhvillimin e takimit të dedikuar të konsultimit në datë 8.6.2021.

**3. Metoda e konsultimit**

Metodat e konsultimit të përdorura për këtë draft raport janë si vijon:

- Dërguar *via email* institucioneve përgjegjëse e zbatuese të PV SNKK dhe Departamentit në KM/ dërguar formati i raportimit për plotësim me shpjegimet dhe detajet e kërkuara. Dërguar formati i raportimit (për masat).

- Komunikimi i drejtpërdrejtë *via email* për cdo kontribut/raportim të marrë; kthim për plotësim informacioni, të dhënash, informacioni i munguar dhe komente të ardhura nga data 30.4.2021–16.5.2021.
- Faqja zyrtare e MD-së, [www.drejtesia.gov.al](http://www.drejtesia.gov.al)
- Tryeza konsultimi e diskutimi teknike, të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.

Takim i realizuar është: në datë 8.6.2021- tryezë ndërinstitucionale konsultimi, zhvilluar online (institucionet e Qasjes A – parandaluese, B – ndëshkuese, Qasjes C- ndërgjegjësuese).

Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit së të dhënave dhe përmbajtjes së draft raportit, u përcollën:

- nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike në stafin teknik të drejtorisë antikorrupsion [rovena.pregja@drejtesia.gov.al](mailto:rovena.pregja@drejtesia.gov.al),
- nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezën e konsultimit të zhvilluar në MD (online).

Gjithashtu Ministria e Drejtësisë/Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit shpalli për konsultim publik draft raportin e monitorimit janar-mars 2021, të planit të veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023 edhe për OSHC-të, duke pritur komente, mendime dhe sugjerime nga ta brenda datës 16 maj 2021, në adresën [ermira.bani@drejtesia.gov.al](mailto:ermira.bani@drejtesia.gov.al).

Nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri u dërguan disa rekomandime për t'u ndjekur, të cilat janë reflektuar në mënyrë korrekte në draft raport, si dhe gjenden të renditura si më poshtë në tabelë.

#### 4. Palët e interesit të përfshira

Draft raporti është konsultuar me përfaqësues të të gjithë institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e PV SNKK dhe të grupeve të interesit në fushën antikorrupsion.

#### 5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Çështja e adresuar	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/ I pranuar pjesërisht/ I refuzuar)	Justifikimi
Kërkohet rishikimi (plotësimi) i strukturës së raportit	KM	I pranuar	Komentet dhe kërkesat për rivlerësimin dhe plotësimin e raportit

<p>sipas metodologjisë së kërkuar IPSIS;</p> <p>Kërkohe të identifikohet arritja e rekomandimeve dhe hapave për zbatimin e tyre sipas Raportit Vjetor 2020;</p> <p>Kërkohe të përputhshmëria e raportit të monitorimit me qasjen strukturore;</p> <p>Shtimi i informacionit analitik lidhur me krahasimin midis 2 periudhave respektive, buxhetit dhe vlerësimit të riskut;</p> <p>Kërkohe të një analizë me fokus të veçantë në disa prej objektivave.</p>		<p>I pranuar</p> <p>I pranuar</p> <p>I pranuar</p> <p>I pranuar</p>	<p>janë evidentuar në mënyrë korrekte në raportin përfundimtar të monitorimit, të miratuar.</p>
<p>Kërkohe të korigjimi i shumës së monitoruesve të trajnuar.</p>	<p>KQZ</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Nuk ka vend për korigjimin e shifrës nga <math>64=32+32^*</math> në <math>64=34+32</math>.</p>
<p>Kërkohe të plotësimi i informacionit për 2 masa të saj respektivisht të A8 dhe A9,</p>	<p>MB</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Është reflektuar plotësimi i informacionit të kërkuar në raport.</p>
<p>Kërkohe të plotësimi i informacionit për aktivitetet A.5.2.1 dhe A.5.5.1.</p>	<p>ILDKPKI</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Është reflektuar plotësimi i informacionit të kërkuar në raport.</p>
<p>Dërgohet për plotësim aktiviteti A.4.5.1.</p>	<p>SHCBA</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Është bërë plotësimi i informacionit të munguar në raport.</p>

Dërgohet për plotësim buxheti i aktiviteteve respektive.	Spektori i statistikave, MD	I pranuar	Është bërë plotësimi i informacionit të munguar në raport.
Dërgohet për plotësim aktiviteti B.1.9.4.	AAPSK	I pranuar	Është bërë plotësimi i informacionit të munguar në raport.
Kërkohe formatim i dokumentit të ngarkuar në <i>web</i> , për nr. faqesh dhe tabelë e përmbajtjes.	IDRA (OSHC)	I pranuar pjesërisht	U shtua numri i faqeve, pasi tabela e përmbajtjes ishte prezente. Struktura dhe përmbajtja e raportit është në zbatim të strukturës së dokumenteve të monitorimit sipas guidës metodologjike IPSIS.